

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES
KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)
MBLEDHJA XIV

Mbi Formalizimin dhe Konkurrueshmërinë në Turizëm

Tiranë, 15 tetor 2018, 15:30 – 17:15

Takimi u mbajt në ambjentet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe u kryesua nga Z. Arben Ahmetaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, me pjesëmarrjen e 12 Anëtarëve të KI dhe përfaqësuesve të tjerë nga disa grupe të interesit në sektorin e turizmit. Në takim morën pjesë rreth 25 vëzhgues që përfaqësonin komunitetin e biznesit, shoqatat e biznesit vendas dhe të huaj dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore si Ministria e Turizmit etj.

I. Hapja e Mbledhjes dhe fjala e Z. Arben Ahmetaj, Kryetar i KI

Fokusi i këtij takimi të Këshillit të Investimeve është sezoni që kaluam, mësimet, arritjet dhe disa refleksime që Këshilli i Investimeve, nëpërmjet këtij dokumenti që ju keni përpara, ka vënë në dukje nëpërmjet gjetjeve, qoftë perceptime përsa i përket pjesës fiskale, qoftë perceptime përsa i përket zhvillimit të sektorit apo edhe shërbimeve. Sezoni turistik i 2018-ës, praktikisht është sezoni më i mirë turistik i shumë e shumë viteve dhe në aspektin e numrave ka qenë vit rekord i vizitorëve të huaj. Por në të njëjtën kohë, edhe në aspektin e formalizimit, sikurse edhe mund ta keni ndjekur, në këndvështrimin tim dhe të stafit që e kanë ndjekur me detaje, ka qenë një sezon shumë i mirë.

Natyrshëm, rritja e turizmit nuk është e rastësishme. Ekonomia shqiptare në 5 vitet e fundit ka performuar në një trend të qëndrueshëm në rritje. Ju të gjithë e mbani mend, rritja ka qenë rreth 1% në 2013-ën, sot jemi në 6 mujorin e parë të vitit 2018 dhe rritja 6 mujore është 4.39, pra 4.4 %, ose rritja më e lartë në 8 vitet e fundit. Nga ana tjetër, është bërë një punë e detajuar në mandatin e parë dhe po vazhdon e fokusuar te rritja e produktivitetit të sektorit të turizmit, ku në vitin 2015-të, dhe këtu po i referohem edhe si ministër përgjegjës i turizmit në atë kohë, ne iniciuam rregullime të rëndësishme në aspektin ligjor, me ligjin e turizmit. E konsultuam të gjithë së bashku, të përputhur edhe me ligjin e investimeve strategjike, atë të zonave ekonomike, duke ofruar incentiva konkrete për nxitjen e investimeve të huaja dhe vendase, edhe në favor të turizmit.

Nga ana fiskale, ulja e TVSH-së 6 % për shërbimin e akomodimit brenda strukturave turistike, e përputhur edhe me lehtësitë fiskale për agroturizmin, jam i bindur që ka dhënë shtysë zhvillimit dhe rritjes së sektorit dhe do të vazhdojë t'i japë. Për ta konkretizuar atë që ka ndodhur me sektorin në shifra, turizmi gjatë 4 viteve të fundit ka rritur kontributin e tij në Prodhimin e Brendshëm Bruto me pothuajse 1 pikë përqindje çdo vit, duke përfaqësuar tashmë pothuajse 15 % të kontributit, nga 11.5 % që ishte në vitin 2013. Turizmi solli në ekonominë shqiptare të ardhura në nivel historik, në vitin 2017 prej 1.7 miliardë euro ose 12 % më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nga viti 2013 rritja është domethënëse, nga 1.1 miliardë euro në 1.7 miliardë euro në vitin 2017 dhe në vitin 2018 presim një shifër prej pak më shumë se 2 miliardë euro. Pra, për 4 vite, flukset hyrëse të lidhura me aktivitetet e turizmit janë rritur me 54.3 % ose mesatarisht me 13.5 % çdo vit. Parë në numrat e vizitorëve, sipas INSTAT, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në 8 mujorin e vitit 2018 është 4.4 milionë duke u rritur me 12.4 % në krahasim me 8 muajt e vitit 2017. Në mbyllje të sezonit turistik, ne në Ministri të Financave dhe Ekonomisë bëmë një analizë më të thelluar për të parë efektet e këtij sezoni, duke

u fokusuar në 5 rajone kryesore: Sarandë, Durrës, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë dhe më duhet ta them që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka bërë një punë shumë të mirë në të dyja korsi, qoftë në formalizim, qoftë në këndin e **sjelljes me sipërmarrjen apo edhe bashkëbisedimin me sipërmarrjen, duke edhe e ndihmuar në edukimin fiskal në territor.**

Në vijim, Ministri Ahmetaj ndan disa statistika nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në periudhën qershor-gusht 2018, në këto rajone, ka një rritje me rreth 19 % të bizneseve të reja neto, ose 1012 biznese me shumë në vetëm këto 2 muaj në këto 5 bashki, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Qarkullimi për periudhën qershor-gusht 2018 është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin e kaluar. Duke ju referuar sërish 5 bashkive që përmenda me lart, ka një rritje të qarkullimit në total 12 %. Më rritjen më të madhe është Saranda me 48 %, Durrësi 10% dhe Vlora 14%.

Ndërkohë, përsa i përket **punësimit**, në fund të gushtit 2018, krahasuar me gusht 2017, rezultojnë 34 mijë të punësuar më shumë në borderonë e Tatimeve në shkallë vendi. Pra, 34 mijë brenda një periudhe prej 1 viti. Në 5 rajonet kryesore turistike janë 11.811 vende të reja. Vetëm në qershor-gusht në këto 5 bashki, janë 11.377 të punësuar, pra efekti i drejtpërdrejtë i sezonit turistik, i reflektuar në rritjen e punësimit dhe të aktivitetit të bizneseve. Në të njëjtën kohë, nuk dua ta lë pa prekur arsimin profesional. Unë besoj se sfida më e madhe është që gjithë këtë kërkesë ta furnizojmë më shërbimet e duhura. Këtu patjetër që ka rëndësinë e vet edhe kualifikimi profesional i punonjësve. Në një sondazh me sipërmarrjen, një nga ankesat më të mëdha që vjen mbrapsht është pjesa profesionale, pjesa e sjelljes dhe e shërbimit pothuajse në të gjitha njësitet e përfshira në sondazh. Sot janë 2711 nxënës që kanë ndjekur profilin e turizmit në shkollat e arsimit profesional për vitin shkollor 2017-2018, krahasuar me 1692 që ishin një vit më parë, pra gati 1 mijë nxënës më shumë. Interesi duket gjithmonë e më shumë në rritje edhe për shkak të punësueshmërisë që ky profesion ka dhe vazhdon të rritet. Nga ana tjetër, shkalla e punësueshmërisë në këto profile arrin 80 %. Pra, 80 % e atyre që mbarojnë shkollën menjëherë punësohen në sektor.

Një e dhënë që desha ta ndaja më ju, që **impakton drejtëpërsëdrejti bashkitë dhe** patjetër që është indikacion për turizmin, është taksa e fjetjes, e cila ka një rritje prej 15 % në 4 muajin maj-gusht të 2018-ës, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Janë sigurisht taksa dhe tarifa bashkiake dhe besoj se si shifër reflekton tek i njëjti konkluzion që ne patëm, duke iu referuar shifrave në rritje qoftë të numrit të vizitorëve, qoftë të numrit të të punësuarve, qoftë të numrit të sipërmarrjes, qoftë të qarkullimit. Ndërkohë, dua të ndaj me ju disa shifra përsa i përket pjesës fiskale; TVSH 6 % dhe këtu besoj kam nevojë për një sekond që të fokusohemi tek shifra jo thjesht e bizneseve që përfituan, por edhe tek shuma që përfituan sipërmarrjet në favor të tyre, atë që dikur do ta merrte buxheti. Janë 1584 biznese që përfituan nga zbatimi i normës së reduktuar të TVSH-së. Për periudhën qershor-gusht ato realizuan mbi 5.2 miliardë lekë shitje të tatueshme me 6 %, duke përfituar 570 milionë lekë, pra gati 5.7 milionë dollar, ulje të pagesa për TVSH-në. Pra, i kemi kursyer këtyre 1584 bizneseve 5.7 milionë dollarë që do t'i paguanin deri më dje shtetit, nëse do të vazhdonim me 20 %, sot ata i kanë në llogaritë e tyre dhe mund t'i përdorin për investime apo për shpenzime në funksion të sipërmarrjes, dhe jam duke folur vetëm për 3 muaj.

Patjetër që është e domosdoshme të përmendim **paketën e hoteleve me 5 yje**. Interesi për ndërtim strukturash akomoduese hotele me 5 yje është në rritje. Janë kërkesa konkrete në Ministrinë e Turizmit dhe te Kryeministri, gati më shumë se 4 projekte të cilat kanë materializuar edhe fazën e parë të përgatitjes së dosjes së detajuar. Paketa e hoteleve me 5 yje presupozon uljen e TVSH-së me normë të reduktuar në 6%, zero tatim fitimi për një periudhë prej 10 vitesh, zero taksë infrastrukture dhe taksë prone gjithashtu. Ndërkohë që menjëherë pas kësaj, duke diskutuar me ju, ne avancuam edhe paketën në anën tjetër të spektrit të hoteleve me 5 yje. Pra, në njërin

anë promovuam investimet e mëdha të hoteleve me 5 yje, në anën tjetër promovojmë edhe paketën e agroturizmit, e cila ofron pak a shumë të njëjtën lehtësi, TVSH-në 6% normë e reduktuar, tatim-fitimi i reduktuar 5% dhe një sërë lehtësish procedurale, për t'i zhvilluar të dyja anët e të njëjtit spektër, që njëri fokusohet tek investimet e mëdha, çdo hotel me pesë yje fillon me vlera të konsiderueshme mbi 10, 15, apo 20 milionë euro, dhe pastaj në varësi të madhësisë dhe të projektit mund të shkojnë mbi 50 apo 60 milionë euro. Ndërkohë që, paketa e agroturizmit fokusohet kryesisht tek zhvillimi i turizmit bio, i referohemi kështu, dhe patjetër që prek drejtpërsëdrejti punësimin në zona të cilat për një moment janë të paprekura plotësisht apo intensivisht nga zhvillimi ekonomik.

Së fundmi, besoj që ju jeni në dijeni të Paketës Fiskale të vitit 2019, që prek tatim-fitimin e fashës 8 deri në 14 milionë lekë xhiro, duke e ulur nga 15% në 5%. Në të njëjtën kohë avantazhon dhe sektorin e bujqësisë me heqjen e TVSH-së për mekanikën bujqësore, por edhe trajton si fermerë të vegjël një kompani të madhe, të mundshme, pra që është dhe SHBB-ja, Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, me logjikën për të kaluar nga ai fragmentarizëm që shohim në bujqësi, në ekonominë e shkallës për ta modernizuar bujqësinë. Në të njëjtën kohë, me paketën e fundit, që është pjesë e paketës së vitit 2019, midis lehtësive të tjera kemi avancuar edhe uljen e Dividentit nga 15 në 8%, besoj duke filluar që nga 1 Janari dhe në të njëjtën kohë, nuk dua të lë pa përmendur dhe atë lehtësim që bëjmë tek tatimi i të ardhurave personale, duke rritur nivelin nga 1 milionë e 300 mijë të vjetra, pra 130 mijë lekë, në 150 mijë lekë të pjesës ku fillon tatimi, ngarkesa mbi 10%. Me këtë i lirojmë ngarkesë fiskale 15.400 të punësuarve, të cilët gjenden në këtë fashë pagese.

Përsa i përket formalizimit, këtu si Ministër i Financave dhe Ekonomisë dua të ndaj me ju një mesazh shumë të qartë sa i **takon formalizimit të sektorit që mbetet ende sfidë**, kjo është e vërteta. Ju e keni parë që ky sezon ka pasur një fokusim shumë të madh të strukturave të terrenit, të tatimeve në zonat me aktivitet turistik. Gjetjet, ju përmenda dhe disa më lart, janë domethënëse dhe përtej shifrave tregojnë se ka akoma shumë hapësirë për t'u përmirësuar në këtë drejtim. Mbi 9.900 kontrolle dhe verifikime në terren. Janë konstatuar mbi 3.500 shkelje. Janë zbuluar penalitete mbi 130 milionë lekë. Nuk ka qenë dhe nuk është fokusi te penalitetet, por fokusi është tek edukimi i tatimpaguesve dhe sigurisht tek formalizimi i mëtejshëm.

Në të njëjtën kohë, ne kemi bërë një hap më tej sa i takon **strukturave akomoduese për formalizim**. Unë kam filluar negociatën me platformat dixhitale të Booking.com, apo AirBNB, për të marrë informacion zyrtar nga këto platforma për të gjithë ato struktura që jepen me qera në territorin e Shqipërisë, po që për arsye se janë shtëpi banimi janë larg syrit, skanerit dhe radarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, apo të institucioneve të FISKU-t. Së shpejti, për shkak të kësaj reforme madhore të fiskalizimit, beteja jonë kundër informalitetit do të kalojë në një nivel tjetër. Dhe projektin shumë të rëndësishëm dixhital, të fiskalizimit që do të realizojë futjen në sistem online dhe në kohë reale të të gjitha transaksioneve biznes me konsumator dhe biznes me biznes, që sigurisht që do ta përshkallëzojë betejën tonë për formalizim në një mënyrë akoma më inteligjente.

II. Prezantim 'Mbi Formalizimin dhe Konkurrueshmërinë në Turizëm'- Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Znj. Diana Leka, Sekretariati i KI, mbajti një prezantim për anëtarët e KI mbi temën e mbledhjes. Prezantimi u nda në tri pjesë: i) Objektivi dhe Metodologjia, ii) Konteksti (*Korniza Strategjike dhe Rregullative e Sektorit, Anketa IC 2018, dhe Nxitjet Specifike*), iii) Gjetjet dhe Rekomandimet (*Qasja Strategjike, Detyrimet Ligjore për Formalizim, Kapacitetet, të tjera*) të përgatitura nga Sekretariati i KI-së në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë, kompani, shoqata biznesi dhe institucione. Përveç

kësaj, znj. Leka paraqiti disa komente dhe çështje të ngritura nga komuniteti i biznesit në anketën e KI (korrik-shtator 2018) si dhe në tryezat e konsultimeve të mbajtura gjatë muajit shtator.

III. Përmbledhje e komenteve kryesore të ngritura gjatë mbledhjes

Z. Matteo Colangeli, EBRD, përgëzoi për shifrat pozitive që tregojnë një rritje të fortë të sektorit të turizmit dhe të numrit të turistëve në Shqipëri. Megjithatë, ai vërejti gjithashtu se shumica mesatare e shpenzuar nga secili prej turistëve të huaj ka rënë aktualisht nga \$525 gjatë 2013 në \$460 në vitin 2017. Sipas tij, fokusi në të ardhmen duhet të zhvendoset nga rritja e numrit të turistëve në rritjen e shumës mesatare të parave që ata shpenzojnë në vend.

Në lidhje me impaktin e informalitetit në konkurrueshmërinë e turizmit të Shqipërisë, Z. Colangeli bëri komentet e mëposhtme:

Së pari, dominimi i transaksioneve në para në dorë jo vetëm që mundëson ekonominë informale, por përbën një disavantazh konkurrues për Shqipërinë, veçanërisht në lidhje me tërheqjen e më shumë turistëve të huaj që vijnë në mënyrë individuale. Operatorët në sektorin e turizmit duhet të ofrojnë mundësinë e prenotimit të dhomave dhe pagesës së shërbimeve me karta krediti.

Së dyti, aksesimi në financa impaktohet shumë negativisht nga informaliteti që e bën ekstremisht të vështirë marrjen e kredive nga sistemi bankar. Ky është një faktor pengues material në përmirësimin e cilësisë së stokut të akomodimit në Shqipëri, që duhet të jetë një prioritet më urgent sesa ndërtimet e reja. Në këtë kontekst, stimulimet fiskale të prezantuara nga qeveria në mbështetje të sektorit dhe veçanërisht ato që lidhen me agro-turizmin, paraqesin një hap shumë të mirë përpara drejt formalizimit dhe drejt më shumë investimeve.

Së treti, është e rëndësishme të forcohet roli i qeverisjes lokale në industrinë e turizmit. Në veçanti, duhet të krijohet një lidhje më e fortë ndërmjet asaj që operatorët në sektorin e turizmit paguajnë, veçanërisht në lidhje me taksimin lokal, dhe atë që marrin në formën e shërbimeve bashkiake, si për shembull shërbimi për menaxhimin e mbetjeve dhe mjedisit, që janë faktorë kyç në tërheqjen dhe mbajtjen e vizitorëve të huaj që bëjnë shpenzime më të larta turistike në vend.

BERZH po punon për disa projekte të përmasave të mëdha që duhet të jenë në zbatim jo më vonë se vitin e ardhshëm, veçanërisht për përmirësimin e infrastrukturës, shumë të nevojshme për zhvillimin e sektorit. Për këtë qëllim, BERZH po punon në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë, BE dhe Bankën Botërore.

Olga Anghelakis, Delegacioni i BE-së, ndërsa vlerësoi punën e mirë të KI-së lidhur me të dhënat e turizmit të paraqitur në tabelë, ajo përmendi se nga 4,4 milion vizitorë gjatë periudhës janar-gusht 2018, rreth 2,1 milionë kanë hyrë në Shqipëri gjatë muajit gusht. Kjo do të thotë se përqendrimi dhe sezonaliteti është shumë i lartë dhe parashikohet të rritet. Cikli i vjetër ekonomik është i shqetësuar nga ky aktivitet i përqendruar gjatë vetëm një muaji.

Një çështje tjetër që duhet rregulluar në turizëm lidhet me ndërtimin e vendpushimeve (resorteve) shumë të mëdha në zona me interes potencial mjedisor, siç është shembulli i Divjakës, aq pranë Parkut Kombëtar të Karavastasë. Prandaj, është e rëndësishme të zhvillohen më shumë modele mjedisore dhe të qëndrueshme të zhvillimit që mbrojnë biodiversitetin dhe burimet e tjera natyrore që përbëjnë një pasuri dhe një vlerë tjetër për Shqipërinë krahasuar me vendet fqinje por edhe me vendet e Bashkimit Evropian. Delegacioni i BE-së mbështet rekomandimin për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit. Komentet zyrtare të Delegacionit janë ndarë me institucionin përgjegjës, shpresohet që disa prej tyre të merren parasysh ndërsa pritet me interes dalja e versionit përfundimtar të miratuar të kësaj kornize strategjike shumë të rëndësishme. E njëjta gjë edhe për reformat strukturore të veçanta në Programin e Reformës Ekonomike 2016-2018 dhe 2017-2019, të cilat kanë të bëjnë me

klasifikimin dhe akreditimin e strukturave të akomodimit, shumë të rëndësishme për zhvillimin e turizmit të cilësisë në vend.

Ministri Arben Ahmetaj, konfirmoi se BERZH po mbështet sektorin e turizmit nëpërmjet një kredie të bashkëfinancuar me Bankën Botërore lidhur me ndërhyrjet e drejtpërdrejta në infrastrukturën e turizmit, më specifikisht mbi konektivitetin e destinacioneve turistike. Përveç numrit të lartë të vizitorëve, është koha të përqendrohemi në përmirësimin e cilësisë në mënyrë që të rrisim vlerën e shtuar në vend. Në lidhje me fokusin kryesor të fushatës së formalizimit, Ministri përmend dy nga katër faktorët e rëndësishëm, i) evazionin fiskal, ii) mosdeklarimin e punonjësve. Këto janë të dy në fakt të lidhur me evazionin fiskal. Në Anketën e KI 2018, disa kontradikta vërehen në mënyrën se si bizneset reagojnë ndaj informalitetit. Pyetjes "*Çfarë sjell më shumë rrezique në një biznes?*" biznesi është përgjigjur duke renditur të fundit - inspektorin tatimor. Ndërsa në krye të vlerësimit rezultoni 'praktikat e padrejta të biznesit', të cilat janë praktikisht evazion. Nga ana tjetër, rreth 74% në mbarë vendin konfirmojnë se ka evazion.

Fokusi i qeverisë për formalizim do të jetë në tre drejtime:

1. *Infrastruktura*. Sot ka shumë projekte për përmirësimin e konektivitetit. Ekziston një projekt i BB me vlerë \$74 milion për ndërhyrje në infrastrukturën e turizmit në zona të caktuara në jug. Një tjetër projekt i BB dhe BERZH ka të bëjë me të gjithë korridoret rrugore që lidhin Shqipërisë nga veriu në jug kombinuar me financim të drejtpërdrejtë nga qeveria, por edhe me instrumente të tjerë si PPP-të. Në tre vjet, në sajë të PPP-ve do të ketë rrugë që nuk mund të ishin ndërtuar në 20-25 vjet. Ekziston edhe një paketë e madhe e ndërhyrjes mbarëkombëtare për përmirësimin e menaxhimit të ujit, veçanërisht ujit të pishëm, në bashkëpunim me KfW, me fokus të veçantë vijën bregdetare.
2. *Formalizimi*. Kjo i mundëson Qeverisë që të marrë kthimin e investimeve në territorin nëpërmjet infrastrukturës së të gjitha llojeve.
3. *Paketa fiskale*. Megjithëse TVSH-ja u reduktua në 6%, ajo nuk nxiti uljen e çmimeve, por paratë e kursyera shkuan si një marzh fitimi. Megjithatë, në njëfarë mënyre, sektori u subvencionua në mënyrë indirekte. Do të ishte mirë nëse në tre-katër vitet e ardhshme e gjithë paketa do të përdoret për rritjen e cilësisë së kapaciteteve në mënyrë që të arrihet optimalja midis numrit dhe cilësisë.

Infrastruktura është rritur në 1.1 miliardë nga PPP-të. Paketa fiskale mbetet më incentivuesja dhe Shqipëria sot është në krye të rajonit. Qeveria zhvilloi gjithashtu paketën për hotelet me 5 yje për të tërhequr emra të markave dhe për të ndërtuar qendra të ekselencës. Duhet të plotësohet hendeku midis aftësive të nevojshme nga sektori dhe atyre të ofruara nga tregu i punës. Edhe biznesi duhet të reflektojë - çka natyrisht mund të ketë nevojë për njëfarë kohe, në mënyrë që të mos vrapojë drejt çmimeve më të ulta por të rrisë cilësinë e shërbimeve.

Turizmi është sektori më informal. Formalizimi është një sfidë madhore. Edukimi nuk duhet të bëhet vetëm nga Ministria e Financave dhe DPT. Është kontroverse të mendosh se formalizimi bëhet përmes masave represive dhe jo të qëndrueshme. Formalizimi duhet të bëhet përmes vetë-edukimit të sektorit, gjithashtu i lehtësuar nga iniciativat e shoqatave së biznesit për të adresuar sfidën kryesore të konkurrencës së pandershme.

Z. Enver Mehmeti, ATA, u shpreh se sektori i turizmit po ka kalon një moment të veçantë sidomos bregdeti shqiptar, mjaft dinamik për shkak të interesit të lartë ndërsa modeli i turizmit duhet të diskutohet më shumë. Ai sugjeroi të rishikohet drafti aktual i strategjisë, të sqarohet modeli i turizmit dhe të mbrohet bregdeti ynë, duke bllokuar ndërtimin e fshatrave turistike që dëmtojnë bregdetin. Ai shprehu mbështetje nga ana e ATA-s për bashkëpunim me qeverinë për formalizimin e sektorit në rast se do të ngrihet një task forcë. Aktualisht, Shqipëria ka nevojë për

një strategji për investime në turizëm prej 365 ditësh në vit. Rritja në dy vitet e fundit ka qenë mjaft e papritur dhe kemi mësuar shumë. Pushteti qendror, pushteti vendor dhe biznesi duhet të punojnë së bashku për të bërë të qartë hapat vijuese në turizëm. Pa dyshim, TVSH-ja e reduktuar në 6%, e kërkuar nga biznesi për shumë vite, ka patur një efekt në industri. Bizneset joformale duhet të edukohen dhe të penalizohen. Nuk mund të pranohet që ditët e sotme biznesi të mos paguajë energji. Më shumë se 50% e të ardhurave rrjedhin nga apartamente me qira. Shoqata ATA është në anën e qeverisë dhe propozon të bëhet një thirrje për bizneset për t'u regjistruar dhe ndërgjegjësim. Qeveria duhet të vendosë një taksë (sipas rajoneve specifike), afate dhe penalitete - kjo është një domosdoshmëri tani - nëse duam një konkurrencë të ndershme dhe të rrisim mbështetjen për investitorët lokalë. Lidhur me punëtorët sezonalë, z. Mehmeti i kërkon qeverisë të subvencionojë kontributin social për këta punëtorë për 5-6 muaj në një vit. Z. Mehmeti kërkoi një balancë midis investitorëve vendas dhe të huaj për të patur akses në incentivat e përfshira në paketën e hoteleve me 5 vje.

Z. Zak Topuzi, ATA/Hotel Mondial, u shpreh se Direktiva e BE-së nr. 114 u miratua në vitin 2006, ndërsa në Shqipëri TVSH-ja u reduktua vetëm në 2017, duke ndihmuar në formalizimin e sektorit. Pjesa më informale e sektorit nuk vjen nga hotelet, por nga apartamentet/vilat e pashitura dhe mund të lidhet me një boshllëk ligjor, i cili mund të rregullohet. Ka rreth 6.400 struktura akomodimi të regjistruara në platformat online, ndërsa 3.900 struktura janë të regjistruara me NUIS. Kjo do të thotë se 30%-40% janë të paregjistruara. Barra më e madhe e formalizimit mbahet nga hotelet e formalizuara. Z. Topuzi shpreh mbështetjen e ATA-s/Divizioni i Hotelerisë në përpjekjet e qeverisë lidhur me formalizimin.

I gjithë rajoni ka përdorur politika shumë stimuluese për turizmin, duke u bazuar gjithashtu në Direktivën e BE-së nr. 114/2016, si p.sh. ulja e taksave vendore, subvencionimi i secilit turisti me 10-15 euro, ulja e kontributit shoqëror për stafin etj. Aktualisht, Shqipëria nuk ka struktura të mjaftueshme akomodimi dhe ka nevojë për politika për rritjen e numrit të strukturave të akomodimit, duke përfshirë hotelet dhe resortet që i shërbejnë mirë turizmit dhe jo fshatrat turistike që shfryzojnë zonën. Në mbyllje, z. Topuzi bëri një thirrje për bashkëpunim me DPT për të përmirësuar Udhëzimin nr. 24, i cili ka krijuar disa probleme zbatimi për hotelet si p.sh., ndër të tjera, printeri fiskal paralel. Ky është një problem shumë shqetësues për të gjithë industrinë.

Znj. Vasili Vjetro, GTD, informon se në tryezën e fundit informuese të mbajtur, DPT shpjegoi shtatë pikat e udhëzimit të lartpërmendur. Kishte disa keqkuptime mbi udhëzimet nga operatorët turistikë, të cilat u konsideruan të sqaruara. Megjithatë, DPT-ja është e gatshme për të diskutuar më tej dhe për të sqaruar të gjitha çështjet. Më shumë se sa çështje problematike, kishte më shumë çështje të keqkuptimit lidhur me aspektet specifike të udhëzimit. Megjithatë, ky është një rekomandim i ri i KI, prandaj mund të rishqyrtohet përsëri.

Z. Kliton Gërxbani, ATOA, mbështeti përpjekjet e ndërmarra për formalizim për të përfshirjen e të gjitha strukturave informale në sistem. Duhet të gjejmë forma për formalizim dhe të kemi një bazë të dhënash të të gjitha strukturave që do të ndihmonte në zgjidhjen e kompleksitetit e çështjeve të turizmit. Duke iu referuar anketës së KI-së, doli që 74% e tregut të turizmit është informal - duke nënkuptuar se nga 5 milion turistë në hyrje, mbi 3 milion janë shërbyer nga struktura të paregjistruara. Kjo do të thotë që kompanitë e formalizuara mund të mos jenë në gjendje të mbijetojnë në të ardhmen për shkak të konkurrencës së padrejtë. Ai përmendi se fokusi duhet të jetë në hotelet 3-4 vje. Një pjesë e madhe e tregut të operatorëve turistikë mbetet informal edhe për shkak të disa mangësive në legjislacion. Operatorët turistikë aktualisht nuk mund të veprojnë me legjislacionin në fuqi, sepse operatorët turistikë nuk ofrojnë siguracione. Kjo për arsye se në ligj nuk është specifikuar baza e shumës për siguracion. Ai kërkoi nga DPT fleksibilitet për të diskutuar në nivel teknik çështjet e reja inovatore që sjell turizmi. Pasi bizneset

janë në sistem, është e vështirë për ta që të dalin prej saj. Ka pasur një numër në rritje të punëtorëve në turizëm. Reduktimi i TVSH-së ka ndikuar edhe në uljen e çmimit, për t'u analizuar më tej sipas segmenteve specifike. Apartamentet duhet të përfshihen në ligj dhe të formalizohen.

Ministri Arben Ahmetaj, u shpreh se pavarësisht nëse banesat janë të përfshira apo jo në ligj, për aq kohë sa ato kryejnë aktivitet ekonomik, pronarët që lëshojnë apartamente me qira duhet të deklarojnë pranë autoriteteve tatimore të ardhurat e tyre nga qiraja dhe të paguajnë tatimin mbi të ardhurat prej 15%.

Z. Maksim Hoxha, DHTI Gjirokastrë/Hotel Çajupi, konfirmoi trendin pozitiv dhe momentin unik të turizmit jo vetëm në Gjirokastrë, por edhe në Tepelenë dhe Përmet. Sa i përket hapave të formalizimit, ai sugjeroi të merret në konsideratë shembulli i Greqisë (EOT) - të gjitha strukturat formale të akomodimit të kenë një etiketë dalluese të dorëzuar nga strukturat e regjistruara lokale ose kombëtare. Kjo është propozuar tashmë në Ministrinë e Turizmit dhe përfshihet në rekomandimet e KI. Z. Hoxha e mbështeti iniciativën e Ministrit për të bashkëpunuar me platformat ndërkombëtare dhe theksoi se formalizimi nuk duhet të trajtohet vetëm nga aspektet fiskale, por edhe nga aspekte të tjera, siç është siguria shëndetësore sidomos për restorantet. Ne duhet të ndërhyjmë tani, më vonë për shkak të numrit të lartë të turistëve që vijnë në qytetet tona pa kushte, kjo mund të bëhet një lloj *boomerang*.

Znj. Natasha Ahmetaj, Banka e Shqipërisë, shprehu miratimin në parim të rekomandimeve të përgatitura nga Sekretariati, duke trajtuar në mënyrë specifike rekomandimin e Sekretariatit për zgjerimin e aktivitetit POS në vend. Dy hapa mund të zgjidhin këtë problem.

1) Banka e Shqipërisë është duke punuar me BB dhe MFE për një *switch kombëtar të pagesave*. Një nga arsyt pse bizneset nuk e pranojnë përdorimin e POS-ve është për shkak të kostos (pagesës së komisionit). Është e pamundur të kalohet nën pragun e imponuar nga sistemi bankar ndërkombëtar për përdorimin e kartave të kreditit. *Switch kombëtar i pagesave* do të lehtësojë shumë përdorimin e pagesave në internet dhe automatikisht do të bëjë më të pranueshëm përdorimin e POS nga biznesi.

2) Prej kohësh, sistemi bankar ka qenë *avant garde* duke investuar në teknologjitë POS dhe të kartave. Kërkesa nga industria e turizmit erdhi përpara ofertës nga sistemi bankar. Modeli i biznesit do ta bëjë të detyrueshëm përdorimin e POS. POS duhet të pranohet në çdo njësi komerciale, sepse heq të drejtën e klientit për të përdorur një instrument pagese të pranuar gjerësisht. Ndoshta pajisja e biznesit me terminal POS duhet të jenë të detyrueshme, për t'i mundësuar çdo konsumatori alternativën e pagesës me kartë krediti/debiti.

Z. Spiro Brumbull, Shoqata e Bankave, theksoi nevojën për metoda alternative të pagesave. Ai përmendi rastin e Greqisë, ku përpara krizës financiare vetëm 10% e pagesave bëheshin me kartë, pas krizës ajo u imponua si një detyrim ku çdo njësi komerciale duhet të kishte një POS, përveç mundësisë së pagesës cash. Deri më sot, mbi 60% e transaksioneve të parave bëhen me kartë. Përpjekje mund të bëhen për të filluar këtë edhe në Shqipëri, ndoshta në sezonin e ardhshëm turistik.

Ministri Arben Ahmetaj, mbështeti sugjerimin e fundit të Bankës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Bankave dhe inkurajon Bankën e Shqipërisë që të fillojë me përgatitjen e sistemit, ndoshta jo më 1 janar, por për të filluar zbatimin në korrik apo shtator për t'i dhënë mjaftueshëm kohë biznesit për t'u përgatitur. Çështja e ngritur nga znj. Leka mbi kostot e mundshme të POS-ve dhe ndikimin i tyre veçanërisht për bizneset e vogla do të trajtohet më tej, ndërsa kjo masë do të diskutohet me BSH.

IV. Mbyllja e takimit

Ministri Ahmetaj falënderoi Sekretariatit për analizën e mirë dhe praktikantët që ndihmuan Sekretariatit në zbatimin e anketës së KI. Çdo sugjerim tjetër që nuk u ngritur në këtë tryezë mund të dërgohet pranë Sekretariatit. Sipas procedurës së zakonshme, procesverbali i takimit do të ndahet me të gjithë anëtarët e KI.

Axhenda për Mbledhjen e adhshme (planifikuar në fillim të muajit dhjetor) do të jetë:

- Inspektimi dhe klima e investimeve

Mbledhja u mbyll në 17:15.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Z. Arben Ahmetaj, Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Financave dhe Ekonomisë
2. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
3. Znj. Vasilika Vjero, Drejtoreshë e Përgjithshme e Tatimeve
4. Z. Arben Seferi, N/Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit Administrativ, në mungesë të znj. Belinda Ikonimi, Drejtore e Përgjithshme e Doganave
5. Z. Sokol Nano, Drejtor Ekzekutiv, AIDA

Përfaqësues të biznesit

1. Z. Turker Sengonul, Zv/President i FIAA-s, në mungesë të z. Tom Kristian Larsen President i FIAA-s
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare e Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL)
3. Zv/Drejtori në mungesë të z. Seyhan Pencabligil, Drejtor Ekzekutiv, BKT

Partnerë ndërkombëtarë

1. Z. Matteo Colangeli, Drejtor i Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
2. Znj. Olga Anghelakis, Shefe e Seksionit të Operacioneve për Reformën Ekonomike dhe Infrastrukturën, Delegacioni Evropian në Shqipëri
3. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese e Zyrës së IFC në Shqipëri
4. Znj. Hilda Shijaku, Ekonomiste pranë Bankës Botërore në Shqipëri

Pjesëmarrës të tjerë nga biznesi i sektorit në tryezë

1. Z. Enver Mehmeti, President, Shoqata Shqiptare e Turizmit
2. Z. Zak Topuzi, Drejtor Ekzekutiv, Shoqata Shqiptare e Turizmit/Hotel Mondial
3. Z. Kliton Gërzhani, Kryetar, Shoqata Shqiptare e Turoperatorëve & Agjencive Turistike
4. Z. Maksim Hoxha, Kryetar i Dhomës së Tregtisë Gjirokastrë, Pronar i Hotel Çajupi
5. Z. Artan Dulaku, Kryetar, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë

Nuk morën pjesë:

1. Z. Edmond Spahiu, Drejtor Ekzekutiv, Alb-Star Sh.p.k.
2. Z. Grigor Joti, Kryetar i Shoqatës Bashkimi Tregtar i Shqipërisë
3. Z. Isuf Ferra, Drejtor Ekzekutiv, Ferraco